



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 80/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Suharekë, paraqitur kundër Kuvendit Komunal të Komunës së Suharekës, për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 3 Nëntor 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 07.08.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Suharekë.

## A r s y e t i m

Në ankesën e parashtruar në PZAP, me datë 06.08.2013, nga subjekti politik LDK, dega në Suharekë, pretendohet se Kuvendi Komunal në Suharekë, në kuadër të aktivitetit kulturor “Diafesti 2013”, ka promovuar projektet e realizuara me llogon e Komunës së Suharekës dhe me llogon e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Më këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore sepse siç theksohet në ankesë dihet se Fushata Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale fillon me 03.10.2013 po ashtu parashtruesi i ankesës pretendon se kjo formë e promovimit nga ana e qeverisë komunale është provokim për qytetarët të cilët dhunshëm detyrohen të identifikohen në “Diafesti 2013”, me subjektin politik AAK.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë 2 (dy) fotografi, me propozim që të ndërmerren masat e duhura konform ligjeve në fuqi.

PZAP-i, duke vendosur sipas ankesës gjeti se:

- **ankesa është e palejuar**

PZAP-i, duke u bazuar ne dispozitat e nenit 33 te LZP-së, me të cilin ndalohen veprimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ashtu siç parashihen në pikat a), b), c), d) të këtij neni, po ashtu me nenin 44 të LZP-së, 44.1 pikat a), b), c) ju përcaktohen te drejtat subjekteve politike për veprimet e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, meqenëse pretendimet ankimore të parashtruesit te ankesës janë zhvilluar para datës së caktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura ligjore, nuk mund të sanksionohet pretendimet e parashtruesit te ankesës ngase veprimet e ndërmarra nga Kuvendi i Komunal në Suharekë duke i promovuar projektet me llogon e komunës dhe me llogon e subjektit politik AAK, nuk parashihen me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore që PZAP-i të ndërmerr masa ligjore para fillimit të fushatës zgjedhore, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**

Anr. 80/2013 më datën 07.08.2013.

**Kryesuesi i panelit**  
**Xhevdet Abazi**



***Këshill juridike:*** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.